



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 1095/prot.
4

Tiranë më 30 . 7 .2021

REKOMANDIM

Nr. 40 , datë 30 . 7 .2021

PËR KONTROLLUESIN “AGJENCIA KOMBËTARE E BARNAVE DHE
PAJISJEVE MJEKËSORE”

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim “Kodi i Procedurave Administrative”), procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit “Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore”,

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 99, datë 30.06.2021 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (në vijim, “Kontrolluesi”), me objekt:

- Verifikimi i ankesës së paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga znj. _____, në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale, në zbatim të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

Zyra e Komisionerit, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit, vëren se:

1. Kontrolluesi është institucion në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë, i specializuar për analizën, regjistrimin, kontrollin e barnave dhe inspektimin e veprimtarive në fushën farmaceutike. Në kuadër të marrëdhënies së punës Kontrolluesi përpunon të dhëna personale për kategoritë e subjekteve të të dhënave “punëmarrës”.

Znj. (në vijim, “ankuesja”) ka qenë e punësuar pranë Kontrolluesit për periudhën nga data 13 maj 2013 deri më datë 11 qershor 2021, fillimisht në pozicionin “analist” në Sektorin e Kontrollit të Vaksinave, e më pas Shef i Laboratorit të Kontrollit. Marrëdhënia juridike e punës ka qenë e formalizuar në Kontratën Individuale të Punës me Nr.Prot.1307/3, datë 13.05.2013 të lidhur midis Punëdhënësit “Qendra Kombëtare e Kontrollit të Barnave”, dhe Punëmarrësit znj.Merita Kuçuku.

2. Në ankesën e paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit, ankuesja pretendon se Kontrolluesi nuk i ka vendosur në dispozicion dokumentacionin e kërkuar në lidhje me:

- (i) Shkresën nr.3469/5 prot., datë 26.05.2021, me objekt: “Kërkesë për dokumentacionin për kthimin e përgjigjes së shkresës nr. 3469/3 prot., datë 25.05.2021”, nëpërmjet të cilës ka kërkuar:
 - Informacion për komisionin e shqyrtimit dhe vlerësimit të masave disiplinore në AKBPM;
 - Dokumentin Memo Informuese me nr.3469/1 prot., datë 18.05.2021, i cili është i përmendur në shkresë;
 - Dokumenti i përmendur në shkresën procesverbal me nr. 3469/2 prot., datë 20.05.2021.
- (ii) Shkresën nr.5950/32 prot., datë 01.06.2021 me objekt: “Kërkesë për sqarimin e objektit të takimit, shkresa nr. 5950/31 prot., datë 01.06.2021”.
- (iii) Kthim përgjigje shkresës nr.3415/3 prot., datë 26.05.2021.

Gjatë hetimit administrativ, është konstatuar se, Kontrolluesi nuk i ka kthyer përgjigje ankueses për dokumentacionin e kërkuar me pretendimin se aktet shkresore të kërkuara prej saj (ankueses) i janë drejtuar punëdhënësit AKBPM- së nga punëmarrësi znj. Merita Kuçuku në cilësinë e “Shefit të Laboratorit të Kontrollit” në kuadër të përmbushjes së detyrimeve sipas legjislacionit në fuqi për marrëdhëniet juridike të punës në Republikën e Shqipërisë.

Kontrolluesi nuk ka ndërmarrë masa për të vendosur në dispozicion të ankueses informacionin e kërkuar me qëllim garantimin e të drejtës së aksesit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, e drejta e aksesit, sipas parashikimeve të nenit 12 të Ligjit, është një e drejtë shumë e rëndësishme e subjektit të të dhënave (në rastin konkret ankueses), që lejon këtë të fundit, të marrë informacion nga Kontrolluesi lidhur me përpunimin e të dhënave të saj dhe në të njëjtën kohë nënkupton vënien në dispozicion të dokumenteve me të dhëna personale.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës dhe, në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesi i Kontrolluesit paraqiti pretendimet me shkrim, si më poshtë:

- Lidhur me informacionin për komisionin e shqyrtimit dhe vlerësimit të masave disiplinore në AKBPM rezulton se punëdhënësi AKBPM zbaton detyrimet me karakter procedural dhe material të parashikuara shprehimisht në nenin 12, 23, 24, 37 të kodit të Punës, Kontratën Individuale të Punës dhe nenet 43,44,45 të Rregullores së brendshme të AKBPM Nr.264 datë 25.09.2017.
- Lidhur me shkresën Memo Informuese me nr.3469/1 prot., datë 18.05.2021, është një dokument individual me karakter informues dhe raportues para Drejtorit të AKBPM-së i punëmarrësit zj.Migena Rizaj në përgjigje të situatës faktike të datës 12.05.2021.
- Lidhur me shkresën nr.5950/32Prot. datë 01.06.2021 është shkresë zyrtare me anë të të cilit punëdhënësi AKBPM njofton me shkrim punëmarrësin të paktën 72 orë para zhvillimit të takimit për të diskutuar në lidhje me marrëdhënien juridike të punës dhe rezulton të jetë ezauruar më datë 04.06.2021 i dokumentuar me protokollin e takimit proces-verbal me nr.5950/33 prot, datë 04.06.2021 i cili është vënë në dispozicion të punëmarrësit znj. Merita Kuçuku nga zyra e protokollit kundrejt shënimit të marrësit.
- Lidhur me shkresën “Kthim përgjigje shkresës nr.3415/3 prot., datë 26.05.2021” nuk është një kërkesë për informacion sipas kriterëve të përcaktuara në nenin 12 të Ligjit por një retorikë e përsëritur e punëmarrësit dhe shmangia nga objekti kryesor i veprimtarisë së punës së saj.

Zyra e Komisionerit vlerëson se pretendimet e Kontrolluesit nuk qëndrojnë për arsye se dokumentacioni i kërkuar përmban të dhëna personale të ankueses dhe për sa kohë nuk ka një kufizim ligjor sipas parashikimit të pikës 5 të nenit 12 të Ligjit, e drejta e aksesit të ankueses nuk mund të mohohet.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 12, 29, 30, 31 pika 1, gërma “a/1”, si dhe 32 të Ligjit,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 12 të Ligjit, të garantojë të drejtën e aksesit për subjektin e të dhënave personale, duke vendosur në dispozicion të ankueses dokumentacionin e kërkuar.
2. Kontrolluesi të kryejë të gjitha detyrimet që burojnë nga Ligji dhe nga ky akt, menjëherë nga momenti i marrjes dijeni dhe të njoftojë me shkrim Zyrën e Komisionerit.
3. Në rast mospërbushjeje, të detyrimeve të parashikuara në këtë akt, Komisioneri vepron sipas pikës 2 të nenit 30 dhe nenit 39 të Ligjit të cilët parashikojnë se në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të Ligjit nga një kontrollues ose

përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, Komisioneri vendos sanksione administrative për kundërvajtjet administrative përkatëse dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot, më datë 30.7.2021

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

